

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Shtërpcës z. Bratislav Nikolić**

I nderuari z. Nikolić,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Uljen e papunësisë;
- Privatizimin e INEX-it – qendrës së skijimit, ku do të sigurohen 500 vende të reja pune,
- Investime në qendrën e skijimit me vëmendje të veçantë në sport dhe kulturë;
- Integrimin e të gjitha komuniteteve;
- Përkujdesje më të madhe ndaj ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë;
- Rrënimin e objekteve që janë jashtë planit, si dhe legalizimin e atyre që janë në përputhshmëri të planit urbanistik;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)